



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN - MUNICIPALITY OF LIPJAN

PLANI PËR PËRMIRËSIMIN E SHËRBIMEVE NGA DREJTORATI PËR GJEODEZI DHE KADASTËR

MAJ 2023



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA

Ky dokument është realizuar me mbështetje nga popullit amerikan përmes Aktivitetit të USAID-it Qeverisja e Pronës. Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e Tetra Tech/ARD dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e USAID-it ose të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

HYRJE

Me mbështetjen e Aktivitetit të USAID-it Qeverisja e Pronës (AQP), në komunën e Lipjanit përkatësisht në Drejtorinë për Gjeodezi dhe Kadastrit (DGJK) është realizuar një vlerësim i proceseve aktuale të ofrimit të shërbimeve, është dokumentuar koha e nevojshme për ofrimin e shërbimeve, janë vlerësuar kapacitetet njerëzore dhe institucionale për qasje dhe mirëmbajtje konsistente të të dhënave sipas modelit të Agjencisë Kadastrale të Kosovës (AKK) dhe Sistemit të Informacioneve Kadastrale për Tokën në Kosovë (SIKTK), ka identifikuar opsionet për të bërë automatizimin e shërbimeve dhe përmirësuar qasjen e qytetarëve në këto shërbime si dhe ka analizuar kornizën rregulluese të drejtave pronësore, procedurave dhe praktikave, me qëllim që të identifikohen dhe dokumentohen mospërputhjet ose devijimet *vis-a-vis* legjisllacionit në fuqi, përfshirë këtu edhe procedurat e ankimimit. Po ashtu në kuadër të vlerësimi është analizuar se a ka ndonjë sjellje diskriminuese e cila mund të pengoj gratë në qasje dhe në marrje të shërbimeve kadastrale efikase dhe të barabarta.

Me qëllim të adresimit të gjitha të gjeturave nga ky vlerësim, Komuna e Lipjanit me mbështetje nga AQP, ka realizuar një punëtori dy ditore më 03-04 Maj 2023, me pjesëmarrje të gjerë nga të gjitha dikasteret e Komunës së Lipjanit dhe përfaqësues nga Agjencia Kadastrale e Kosovës.

Punëtorja është mbajtur në 3 (tri) grupe tematike të punës: Grupi I-Gjeodezi dhe Kadastër, Grupi II-Pjesa Ligjore dhe Grupi III-Përfshirja Gjinore dhe Sociale.

Planin i Përmirësimit të Ofrimit të Shërbimeve përmban të gjeturat nga raportet e vlerësimit dhe ofron rekomandime konkrete për përmirësimin e kualitetit dhe rritjen e efikasitetit në ofrimin e shërbimeve nga DGJK.

Ky dokument ka detajuar veprimet për zbatimin e rekomandimeve, duke identifikuar të gjitha veprimet që duhet të ndërmerren, autoritetet përgjegjëse, ndikimet buxhetore, afatet kohore si dhe rreziqet dhe sfidat që do të afektonin në arritjen e qëllimeve të parapara në plan.

AQP në vazhdimësi do të asistojë Komunën e Lipjanit në mënyrë që rekomandimet nga ky plan, të konkretizohen me veprime konkrete, në të njëjtën kohë, ky plan do të mbikëqyret dhe raportohet për nivelin e zbatimit të tij nga DGJK Lipjan, Komiteti për Praktika të Mira dhe Forumi për Transparencë të Pronës.

SHKURTESAT

ABGJ	Agjencia për Barazi Gjinore
AKK	Agjencia Kadastrale e Kosovës
ARC	Agjencia e Regjistrit Civil
DGJK	Zyra Kadastrale e Komunës
KK	Kuvendi Komunal
LK	Ligji për Kadastër
LKPP	Projektligji për Kadastër të Pronës së Paluajtshme
LPPA	Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative
LRDPP	Ligji për Themelimin e Regjistrit të të Drejtave të Pronës së Paluajtshme
MMPHI	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
PGA	Aktiviteti Qeverisja e Pronës
QeK	Qeveria e Kosovës
RDPP	Regjistri i të Drejtave të Pronës së Paluajtshme
SIK	Sistemi i Intranetit të Komunës
SIKTK	Sistemi i Informacionit Kadastral për Tokat në Kosovë
ZIP	Zyra për Informim të Publikut
ZKM	Zyra e Kryeministrit

PLANI PËR PËRMIRËSIMIN E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE KADASTRALE - KOMUNA LIPJAN

PJESA E KADASTRIT DHE GJEODEZISË

Nr.	TË GJETURAT	Nr.	REKOMANDIMET	VEPRIMET QË DUHET TË NDËRMERREN	AUTORITETI PËRGJEGJËS	NDIKIMET BUXHETORE (EUR)	AFATET KOHORE	RREZIQET DHE SFIDAT
1	Ri-organizimi i sportelit	1.1	Ndarja e sportelit me xhama lëvizës	Kërkesa nga Drejtoria e Gjeodezisë dhe Kadastrit tek Drejtoria e Administratës dhe tek njësia e prokurimit	Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër, Drejtoria e Administratës dhe njësia e prokurimit	500	Qershor 2023	Nuk parashihen rreziqe
		1.2	Gjatë orarit me palë (3 herë në javë), sporteli të përdoret si zyrë pritëse për palë	Vendimi nga Drejtori i Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër	Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër	Nuk ka	Qershor 2023	Nuk parashihen rreziqe
		1.3	1 Kompjuter dhe 2 monitor	Kërkesa nga Drejtori i Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër tek Drejtoria e Administratës dhe tek njësia e prokurimit	Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër, Drejtoria e Administratës dhe njësia e prokurimit	950	Shtator 2023	Nuk parashihen rreziqe
2	Mungesa e resurseve teknologjike	2.1	4 Kompjuter	Kërkesa nga Drejtori i Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër tek Drejtoria e Administratës dhe tek njësia e prokurimit	Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër, Drejtoria e Administratës dhe njësia e prokurimit	2,500	Shtator 2024	Vonesa në procedurë të prokurimit
		2.2	1 Printer	Kërkesa nga Drejtoria e Administratës tek kompania e kontraktuar	Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër dhe Drejtoria e Administratës	Nuk ka	Shtator 2023	Nuk parashihen rreziqe
		2.3	1 Skaner	Kërkesa nga Drejtoria e Administratës tek kompania e kontraktuar	Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër dhe Drejtoria e Administratës	Nuk ka	Shtator 2023	Nuk parashihen rreziqe

3	Mungesa e burimeve njerëzore	3.1	1 zyrtarë për punë në sportel	Kërkesa nga Drejtori i Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër tek njësia e personelit dhe zyra e kryetarit	Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër, njësia e personelit dhe zyra e kryetarit	420x12=5040 euro në vit	Qershor 2024	Kufinjët bugjetor për numër të përdorëve
4	Digjitalizimin i planeve të kashiruara	4.1	Të bëhet skanimi dhe gjeoreferencimi i planeve të kashiruara	Kërkesa nga Drejtoresha e Administratës tek kompania e kontraktuar për skanim	Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër dhe Drejtoria e Administratës	850	Tetor 2023	Pa mundësia e kryerjes së shërbimit të tillë nga operatori
		4.2	Gjeoreferencimi	Kërkesa nga Drejtori i Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër tek Agjencia Kadastrale e Kosovës	Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër dhe Agjencia Kadastrale e Kosovës	Nuk ka	Nëntor 2023	Nuk parashihen rreziqe

PJESA LIGJORE							
Nr.	TË GJETURAT	REKOMANDIMET	VEPRIMET QË DUHET TË NDËRMERREN	AUTORITETI PËRGJEGJËS	NDIKIMET BUGJETORE (EUR)	AFATET KOHORE	RREZIQET DHE SFIDAT
1	DGJK e respekton të drejtën e palëve për trajtimin e kërkesës për rishqyrtim të vendimit të DGJK-së siç përcaktohet me Ligj, ka mundësi që brenda DGJK-së të krijohen praktika për përmirësimin e këtij procesi.	Te rastet e kërkesave për rishqyrtimin e vendimit të DGJK-së, Drejtorati i DGJK-së, brenda mundësive por duke mos e kufizuar në tërësi të kujdeset që personi përgjegjës për trajtimin e këtyre kërkesave mos të jetë zyrtari i njëjtë i cili e ka refuzuar kërkesën për regjistrim fillestar mirëpo në rastet kur ka mungesë të zyrtarëve tjerë rishqyrtimin mundë të bëhet edhe nga zyrtari që e ka refuzuar kërkesën për regjistrim fillestar.	Trajnimi i zyrtarëve për legjislacionin kadastral duke përfshirë edhe procedurat për shqyrtimin e kërkesave për rishqyrtim të vendimeve të DGJK-së	AQP, DGJK dhe AKK	Nuk ka	Zyrtarët do të trajnohen deri më 29 maj 2024	Nuk ka
2	LRDPP përcakton që çdo ZKK të mbajë tabelën e shpalljeve publike ku afishohen njoftimet e kërkesave për regjistrim për të paktën pesë ditë pune përpara nxjerrjes së vendimit që lejon regjistrimin. Njoftimi duhet të përmbajë: adresën e pronës, dhe nëse është e mundur, numrin e ngastrës kadastrale; të dhënat për personin prej të cilit bëhet bartja e të drejtës mbi pronën; të dhënat për personin që me regjistrim e fiton të drejtën mbi pronën; të drejtën që duhet të regjistrohet; dhe datën deri kur çdo palë e interesuar mund të paraqitë kundërshtimin të ZKK. ZKK në disa raste nuk e afishon këtë njoftim në tabelën e shpalljeve publike, siç kërkohet me ligj.	DGJK duhet ta mirëmbajë tabelën e shpalljeve publike dhe t'i afishoj njoftimet e kërkesave për regjistrim për të paktën pesë ditë pune përpara nxjerrjes së vendimit që lejon regjistrimin.	Vendosjen e afisheve në vendin paracaktuar për shpallje publike, në momentin që printohen nga sistemi SIKTK i AKK-së	Shefi i Sektorit të Kadastrit/ Drejtori i DGJK-së	Nuk ka	Gjatë tërë kohës duke filluar nga Qershori 2023	Nuk ka

PËRFSHIRJE GJINORE DHE SOCIALE							
Nr.	TË GJETURAT	REKOMANDIMET	VEPRIMET QË DUHET TË NDËRMERREN	AUTORITETI PËRGJEGJËS	NDIKIMET BUXHETORE (EUR)	AFATET KOHORE	RREZIQET DHE SFIDAT
1	Udhëzimi Administrativ (QKR) 03/2016 për masat e veçanta për regjistrimin e pasurisë së përbashkët të paluajtshme në emër të të dy bashkëshortëve, i ndryshuar dhe plotësuar me UA (KKR) 04/2017, është derivat i masave të përkohshme afirmative të përcaktuara me Ligjin për Barazinë Gjinore. Te shqyrtohen masa të tjera afirmative për të rritur regjistrimin e pronës në emër të dy bashkëshortëve.	Zyra për barazi gjinore të organizojnë fushata vetëdijësuese për rëndësinë e regjistrimit të pronës në emër të dy bashkëshortëve.	Zyrtari komunalë për çështje gjinore duhet të pajisen me mjete të duhura financiare dhe logjistike për të ofruar trajnime/punëtori informative në zonat urbane dhe rurale për të drejtat e regjistrimit të pasurisë së përbashkët në emër të dy bashkëshortëve. OJQ-të të bashkëpunojnë me Grupin e Grave, Zyrën për Barazi Gjinore për fushata vetëdijësuese;	Kryetari i Komunes; Zyra për Barazi Gjinore, Grupi i Grave; OJQ-të.	Fushatat vetëdijësuese: 3,000 Euro	Pjesa e dytë e vitit 2023	Mungesa e buxhetit; mungesa e resurseve njërzore; rezistenca e grupeve të caktuara sociale të përfshihen në aktivitete (burra dhe gra).
		Agjencia për Barazi Gjinore ta bëjë të përhershme masën afirmative dhe ta zgjëroj edhe te nënat vetushqyese (grupet ma të cënueshme); Përfshirja e Organizatave e Shoqërisë Civile dhe përkrahja e tyre nga donatorët e ndryshëm, Qeveria, Komuna.	Fushatë vetëdijësuese në rrjetet sociale komunale/media lokale dhe nacionale nga Kryetari i Komunës për rëndësinë e regjistrimit të pronës në emër të dy bashkëshortëve. Të hulumtohen masat stimuluese nga Kryetari i Komunës për çiftet që regjistrojnë pronën në emër të dy bashkëshortëve.	Kryetari i Komunes; Zyra për Barazi Gjinore, Grupi i Grave; OJQ-të.			
2	Zbatimi i masave mbrojtëse të parapara me Ligjin për Trashëgiminë dhe Ligjin për Procedurën Jokontestimore do t'i fuqizonte gratë në procedurat dhe proceset e trashëgimisë. Aktvdekja është dokumenti ligjor që i identifikon trashëgimtarët e mundshëm dhe është esencial për iniciimin ligjor të procedurës së trashëgimisë.	Zyrat e Gjendjes Civile t'i zbatojnë dispozitat e Ligjit për Trashëgiminë dhe Ligjit për Procedurën Jokontestimore gjatë nxjerrjes së akteve të vdekjes sipas detyrës zyrtare dhe ta eliminojnë përjashtimin e mundshëm të grave dhe anëtarëve tjerë të familjes, nga trashëgimia si rezultat i mosdeklarimit në trashëgimi, përmes programit të gjendjes civile i cili duhet të ketë trungun familjar.	Të trajnohen zyrtarët e Gjendjes Civile në Komuna për çështjen e trashëgimisë, dhe lëshimit të aktit të vdekjes në mënyrë që të mos përjashtohen gratë nga trashëgimia.	Agjencia e Regjistrimit Civil; IKAP; Zyrat e gjendjes civile OJQ-të, Oda e Noterëve	Ndikim buxhetor për trajnim: 1000 Euro	Zyra e Kryetarit, Drejtoria e Administratës	Mosdisponueshmëria e zyrtarëve civil për shkak të dinamikës së punës.
			Trajnimi i noterëve për implementimin e procedurave që e sigurojnë qasjen e grave në trashëgimi.				

3	Duhet te krijohen masa dhe te ndërmiren veprime të veçanta për mbështetjen e grave për zhvillim te qëndrueshëm ekonomik në nivel komunal.	Krijimi i një fondi komunal të përhershëm për t'u ndihmuar grave në biznes, e posaçërisht grave që fillojnë biznese të reja; Të krijohen mundësi për grante të vogla për blerje të paisjeve prodhuese dhe përpunuese, gjithashtu ne fushën e bujqësisë: subvencionimin me bagëti apo paisje për gratë në bujqësi; Të shikohen mundësitë e prioritizimit të aplikantët të cilët e kanë të regjistruar pronën në emër të dy bashkëshortëve gjatë ndarjes se subvencioneve në fusha të ndryshme në komunë.	Të iniciohet diskutimi për përfshirje në planifikim buxhetor krijimi i një fondi të përhershëm komunal dhe alokimi i buxhetit; Të nisin konsultimet me Ministrinë e Financave për krijimin e një kodi të përheshëm buxhetor; Të përfshihet si kriter regjistrimi i pronës në emër të dy bashkëshortëve gjatë aplikimit për subvencione në komunë.	Drejtorati për Buxhet dhe Financa, Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim, Drejtorati për Zhvillim, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport; Kuvendi Komunal; Ministria për Buxhet e Financa, MAPL.	Fillimisht të planifikohet një shumë nga 10000 Eur nga Komuna si përkrahje për biznese të grave.	Të fillohet më përgaitje nga qeshori i vitit 2023. Implementimi të filloj nga vitit 2024-2025.	Mungesa e buxhetit; mungesa e vullnetit nga Ministrinë relevante për caktimin e kodit dhe ligjshmërisë.
4	Nxitja e debatit social nga shoqëria civile dhe zyrat për barazi gjinore dhe të drejtat e njeriut, përfshirë drejtorët dhe përfaqësuesit e zyrave te ndryshme në komune, si dhe asamblistëve, për t'i informuar gratë për pasojat negative ligjore dhe sociale nga heqja dorë nga trashëgimia dhe rëndësia e regjistrimit të pronës në emër të dy bashkëshortëve.	Të sigurohen resurse të mjaftueshme financiare dhe njerëzore për zyrtarët e barazisë gjinore dhe zyrtarët tjerë komunal që të ndërmarrin fushata vetëdijësuese, me theks te veçante në viset rurale. Informata rreth legjislacionit në fuqi për gratë dhe grupet tjera të cënueshme.	Të organizohen fushata vetëdijësuese me theks me gratë në viset rurale dhe gratë nga komunitetet jo shumicë. Fushtat të përfshijnë informata rreth të drejtave pronësore (pronë dhe trashëgimi) sipas legjislacionit në fuqi dhe masave afirmative.	Zyrtari për Barazi Gjinore/Njësia për të Drejtat e Njeriut. , Zyrja për Informim, Zyrja për Komunitete dhe Kthim, zyrja e Kryetarit, Grupi i Grave Asambleiste.	Buxhet i ndarë për fushata vetëdijësuese me grupet e interesit: 4000 Eur	Me aktivitetet fillohet nga gjysma e dytë e vitit 2024 e në vazhdimësi. Vlerësimi i nevojave të grave nga komunitet jo shumicë të filloj nga gjysma e dytë e vitit 2023.	Mungesa e buxhetit; mungesa e resurseve njerezore; hezitimi për përfshirje në aktivitete të grave nga komuniteti jo shumicë.
5	Personat me nevoja të vecantë kanë njohuri shumë elementare mbi kornizën legjislative për të drejtat pronësore dhe trashëgimore. Nevojiten fushata vetëdijësuese për personat me nevoja të vecanta për qasje në pronë dhe trashëgimi.	Objekti i komunës së Lipjanit kryesisht e ka të rregulluar infrastrukturën publike për qasje për persona me nevoja të vecanta, por mbetet ende për tu bërë. Të ngritet vetëdija për rëndësinë e regjistrimit të pronës në emër të dy bashkëshortëve dhe proceseve të trashëgimisë për këtë kategori. Të identifikohen personat me nevoja të vecanta nga komunitetet jo shumicë.	Organizimi i punëtorive me përfaqësuesit e OJQ-ve dhe Këshillit komunal për Persona me Nevoja të Vecanta nga fusha e nevojave të vecanta për të identifikuar saktësisht nevojat dhe problemet me të cilat ballafaqohet kjo kategori. Të organizohen fushata vetëdijësuese për rëndësinë e regjistrimit të pronës në emër të dy bashkëshortëve dhe proceseve të trashëgimisë. Komuna të angazhohet për sigurimin e paisjeve (kompjuterit me alfabetin e brajllit nëpër insitucione shkollore), interpret për gjuhën e shenjave, shiritat për ecje për persona me të pamur të dëmtuar.	Zyrja e Kryetarit, Këshilli Komunal për Persona me Nevoja të Vacanta, Zyrja për Barazi Gjinore/Njësia për të Drejtat e Njeriut, Grupi I Grave, QPS, Drejtoratet Relevanta.	10,000 Eur	Nga gjysma e vitit 2023 e tutje.	Mungesa e buxhetit; hezitimi për përfshirje në aktivitete të personave me nevoja të vecanta për shkak të mungesës së stimulimit (transportit dhe mbikqyrësit).